



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 2

Prishtinë, më 23.10.2017, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë : Daut Haradinaj, Srdjan Mitrovic, Ali Lajçi, Lutfi Zharku, Enver Hoti, Danush Ademi.

Munguan : Besa Gaxherri, Ganimete Musliu, Liburn Aliu, Salih Salihu, Andin Hoti.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë : sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Daut Haradinaj**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 9.10.2017,
3. Takimi i komisionit me ministrin e bujqësisë lidhur me planin dhe prioritetet e ministrisë,
4. Shqyrtimi i draft planit të punës së komisionit për vitin 2017,
5. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 9.10.2017

Kryetari i Komisionit konstatoi miratimin e komisionit për procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

3. Takimi i komisionit me ministrin e bujqësisë

Kryetari Daut Haradinaj falënderoj ministrin Rikallo dhe ekipin e tij për pjesëmarrje dhe sugjeroi fillimisht ti japi fjalën pasi që pastaj do të pasojnë pyetjet apo eventualisht ndonjë shtesë tjetër. **Ministri i bujqësisë** gjithashtu falënderoi për ftesën dhe bashkëpunimin e përafërt që do ta ofron kjo ministri në vijim me këtë komision gjithnjë me transparencë dhe punë publike. Ai shkurtimisht njoftoi me gjendjen solide që ekziston në ministri dhe punën që zhvillohet aty sidomos me 4 projektligje shumë të rëndësishme : pyjet, ushqimi, alkooli dhe zhvillimi rural të cilat janë duke u përgatitur dhe ofrojnë zgjedhje të mira, gjithashtu potencoi edhe buxhetin i cili poashtu do ti përshtatet kushteve ekzistuese por edhe zhvillimit ekonomik. Pasi që paraprakisht kryetari i komisionit ka dërguar pyetjet me shkrim dy ministrive, ministri fillimisht u përgjigj në ato rreth verërave dhe listën e kërkesave siç tha ai të arsyeshme dhe ndryshimin e ligjit ekzistues sa i përket lirimit nga obligimet doganore, taksat, akcizat e verërave për eksport e import, shpalljen e zonës së mbrojtur për vreshtat, mungesën e inspektimeve etj, gjithashtu shtoi se ligjin për verëra ministria e mbështet në bazë të UA nga viti 2013 për çka edhe ka ftuar sekretarin e MB Kapllan Halimi, drejtorin Bekim Hoxha dhe kryeshefin Elhami Hajdarin për sqarime më të detajizuara. Sekretari e potencoi faktin se ligji i verërave është më i përkrahshmi në ministri dhe atë me pagesa të qiftëzuara dhe pagesa direkte me grande, ndërkaq inspektimin do ta përfshij ligji për pije alkoolike të cilat fakte ky komision do ti shoh edhe më mirë nëse bashkëpunimi vazhdon edhe me vizita në terren. Sa i përket kërkesës për heqjen e akcizës së verërave kjo çështje, vazhdoi sekretari, është i nivelit botëror që do të thotë nëse hiqet ajo atëherë duhet të heqim atë edhe nga gjitha produktet tjera, për të gjitha këto parakushte ne do ti ofrojmë komisionit përgjigje edhe të shkruar. Lidhur me subvencione theksoi se ato janë të kategorizuara dhe ministria me rëndësi e ka prodhuesin dhe shitësin, ngase duke u nisur nga ky fakt kompanitë janë shumëfishuar. **Kryetari** ndërhyri rreth ndalesës së fidaneve ballkanike për të cilin sekretari u përgjigj se këto masa janë si rezultat i kërkesave nga komisionit evropian kur kanë hy fidanët e sëmura, pra për ti evituar sëmundjet e ndryshme janë vendosur parametra evropiane. **Enver Hoti** përkrahu takimin e sotëm por vetëm në aspektin informativ ngase siç tha ai në terren kemi mjaft probleme dhe parregullsi sidomos me grante e subvencione (**Kryetari z. Haradinaj** ndërhyri dhe përkrahu z. Hoti duke premtuar kontrollin parlamentar maksimal ndaj ministrisë lidhur me ato, ngase siç tha “ato i takojnë popullit”). Z. Hoti potencoi një shembull nga praktika (mjedrave) ku gjatë aplikimeve të ndryshme të fermerëve ata po hasin në probleme sidomos “me fjalën ETJ” e cila fjali po devijon sipas tekeve të ndryshme, këto gjëra, përfundoi ai, duhet të qartësohen ose thënë më shkurt të ndërpriten. **Kryetari** gjithashtu kërkoi aplikimin e sistemit elektronik për fitimin e subvencioneve dmth pa ndërhyrje të askujt, ngase si mund të komentohet p.sh. një fshat të fitoj 11 subvencione kurse një komunë e njohur si bujqësore vetëm një. **Ali Lajçi** u bashkëngjiti me kërkesa gjithashtu të ngjashme sa i përket largimit të abuzimeve të ndryshme ngase Kosova në përgjithësi ka nevojë për kontroll ligjorë, kurse sa i përket planit të parashikuar ai potencoi 14 projektligjet e parashikuara por kërkoi qasje më kualitative ngase nuk shkon vetëm të ndryshojmë ligje pa pasur qasje në problemet madhore si p.sh. fakti pse nuk punohet toka në Kosovë, si të rritet prodhimi, përfitimi dhe punësimi etj, pra nuk kemi ligje finale por kemi vetëm ligje që ndryshojnë nenet. Veçanërisht kërkoi angazhimin e ministrisë rreth parqeve nacionale duke potencuar edhe demarkimin aktual ku përfshihen shumë probleme pronësore. Edhe për këtë diskutim kishte ndërhyrje nga **kryetari** ngase siç potencoi ai problemet pronësore janë ato që vazhdimisht do të krijojnë situata të paqëndrueshme siç janë p.sh. kthimi disa herë në qeveri të Ligjit për pyje, Brezovica, prerja ilegale e pyjeve etj. **Danush Ademi** u bashkëngjiti pyetjeve dhe kritikave sidomos për minoritete të cilët sipas tij shumë vështirë apo fare nuk vijnë tek subvencionet apo grantet, pastaj si pasojë ndodhin largimet e ndryshme nga vendi ku jetojnë, ndërkaq për këto raste **kryetari** premtoi se komisioni do të angazhohet në mënyrë direkte për ti vërtetuar faktet e potencuara nga deputeti ngase pakicë apo jo ndarjet duhet të shpërndahen si duhet dhe me ligj.

Pasi që mori fjalën edhe një herë, **ministri** tha se ankesat e ndryshme janë ose mund të jenë të karakterit personal, prandaj kërkoi nga komisioni që sugjerimet të dërgohen në sistemin e punës së ministrisë ku do të sistemohen dhe do të ketë transparencë e publicitet maksimal, në mënyrë që edhe minoritetet të arrijnë me plotësua kriteret që kërkohen, ngase pikërisht kjo ministri nuk do të ketë në punën e sajë politike por vetëm punë. Për fund ai edhe një herë falënderoi dhe ftoi në bashkëpunim për çdo detal.

4.Të ndryshme

Në pikën të ndryshme Kryetari njoftoi për mbledhjen e radhës me ministren e mjedisit kurse për planin e punës sugjeroi që në mbledhjen e radhës të shikohet mundësia e miratimit apo të shtyerjes së miratimit, ngase janë edhe disa çështje të bashkëpunimit të cilat duhet të inkorporohen në këtë plan

Mbledhja përfundoi në orën 12,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Daut Haradinaj